Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Valmirë Deliu	**19.02.2025**	**21.02.2025**	**2025/0120**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.02.2025, **OE "Gentian Sakaj B.I."**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0120, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" - Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"FURNIZIM ME ANTIFRIZ DHE UJË TË XHAMAVE PËR AUTOMJETET E PK-se"** me nr. të prokurimit: **"214-24-13297-1-2-1"**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës:**80,000.00 €.**

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim i mëparshëm i OSHP-së.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Në ankesën e paraqitur nga **Gentian Sakaj B.I.** kundër Autoritetit Kontraktues - **Policia e Kosovës** lidhur me tenderin për "Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së", pretendohet shkelja e disa dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Dispozitat e Shkelura:

- **Neni 1: Qëllimi**
- **Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7: Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**

Pikat Kryesore të Ankesës

1. Mungesa e Garancionit të Prodhuesit nga OE i Rekomanduar
2. Përzierja e Kërkuar për Arritjen e Specifikimeve Teknike
3. Ndryshimi i Njësisë Matëse nga Kilogram në Litër
4. Kosto Shtesë për Ujin e Destiluar
5. Trajtim i Pabarabartë dhe Diskriminim ndaj Ankuesit

Për më tepër, referojuni ankesës së plotë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

Nr	Emërtimi	Njësia	Paketimi	Sasia
	Pjesa A 60%			
1	**Ujë të xhamave -25C**	**Litër**	**1 Litër**	**1**
	Pjesa B 40%			
2	**Antifriz G-12** **pika minimale të qëndrushmërisë ndaj ngrirjes duhet ta ketë artikulli - 37 gradë celisius.**	**Litër**	**1 Litër**	**1**
3	**Antifriz G-13** **pika minimale të qëndrushmërisë ndaj ngrirjes duhet ta ketë artikulli - 37 gradë celisius.**	**Litër**	**1 Litër**	**1**

Vërejtje:

- Për secilin artikull kompania ofertuese duhet ta dorëzoj në ditën e ofertimit nga një mostër- obligative.
- Afati I liferimit duhet të jetë 10 ditë kalendarike.
- Garancioni për artikullin nr 2,3 duhet të jetë minimum 5 vite kurse për artikujt tjerë me nr:1 minimum 1 vit.

Lista e çmimeve

Nr	Emërtimi	Njësia	Paketimi	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH	Emri I prodhuesit - vendi I origjinës (OE është i obliguar që të shkruaj për secilin artikull këto të dhëna, në të kundërtën oferta do të refuzohet)
	Pjesa A 60%						
1	Ujë të xhamave -25C	Litër	1 Litër	1			
					Totali për Pjesën A		
	Pjesa B 40%						
2	Antifriz G-12 pika minimale të qëndrushmërisë ndaj ngrirjes duhet ta ketë artikulli -37 gradë celisius.	Litër	1 Litër	1			
3	Antifriz G-13 pika minimale të qëndrushmërisë ndaj ngrirjes duhet ta ketë artikulli -37 gradë celisius.	Litër	1 Litër	1			
					Totali për Pjesën B		

Page 1

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

2.	Gentian Sakaj B.I. 811044833	Ne dosjen e tenderit te specifikat teknike është kërkuar njësia matëse litër ndërsa OE tek artikulli 2 dhe 3 ,Antifriz G12 dhe G13 nuk përputhen specifikat teknike te njësia matës e cila është ofruar me kilogram nga OE, ndërsa nga njësia kërkuese është kërkuar me litër. Andaj oferta juaj është e pa përgjegjshme
4.	Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa " 600165866	OE- ka plotësuar Kriteret Administrative dhe mostrat e dorëzuara kane plotësuar specifikat teknike . Andaj rekomandohet për kontrate.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Gentian Sakaj B.I.**

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet e ankuesit në raport me vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe paraqet konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1

Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", ka dorëzuar mostra të ujit të xhamave, antifrizit G12 dhe G13, të cilat nuk përmbajnë garancionin e prodhuesit, siç pretendohet se kërkohet në specifikimet teknike. Ankuesi thekson se, duke qenë se ky operator nuk është vetë prodhues, ishte e domosdoshme të siguronte garancionin nga prodhuesi për produktet e ofruara.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues vëren se në Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues (AK) ka kërkuar që:

- Garancia për artikujt nr. 2 dhe 3 duhet të jetë minimum 5 vjet, ndërsa për artikullin nr. 1 minimum 1 vit.

Nga këto kërkesa nuk rezulton që është kërkuar specifikisht garancia nga prodhuesi.
Prandaj, pretendimi i ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar garancinë e prodhuesit, nuk është i bazuar në kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, të përcaktuara në Aneksin 1 të DT-së.

Pretendimi Ankimor 2

Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se AK – Policia e Kosovës ka rekomanduar për kontratë një OE, i cili nuk përmbush specifikimet teknike për antifrizët G12 dhe G13, bazuar në mostrat e dorëzuara.
Sipas ankuesit, specifikimet kërkojnë që produktet të kenë një pikë ngrirjeje minimale prej -37°C, ndërsa mostrat e ofruara kërkojnë përzierje me ujë të destiluar në raport 50/50 për të arritur këtë temperaturë.
Ankuesi thekson se kërkesa ishte për produkte që arrijnë këtë temperaturë pa përzierje shtesë, dhe kërkon sqarim nga Autoriteti Kontraktues mbi pranimin e këtyre produkteve që, sipas tij, nuk plotësojnë kriteret e kërkuara.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Eksperti shqyrtues ka analizuar në platformën e-prokurimi kërkesat e AK-së të përfshira në Aneksin 1, Specifikimet teknike të detyrueshme të DT-së dhe ka gjetur se AK nuk ka specifikuar qartë që antifrizi duhet të arrijë -37°C pa përzierje.
Në dokumentet e tenderit, është kërkuar vetëm që produkti të ketë pikën minimale të ngrirjes -37°C, pa ndonjë sqarim shtesë mbi mënyrën e arritjes së kësaj temperature.
Sipas ekspertit shyqrtues, në mungesë të një specifikimi të qartë nga AK, diskualifikimi i ofertës së OE të rekomanduar vetëm mbi bazën e përzierjes, nuk ka një bazë të qartë ligjore, pasi AK nuk ka specifikuar qartë që antifrizi duhet të arrijë -37°C. Nëse AK kishte qëllim të kërkonte antifriz që arrin -37°C pa përzierje, atëherë kjo duhej të ishte përcaktuar qartë në Specifikimet Teknike të tenderit.
Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se sipas LPP-së, specifikimet teknike duhet të jenë të qarta dhe të detajuara për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe efektive. Neni 28 i këtij ligji përcakton se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë kërkesat e AK-së,

duke shmangur çdo referencë që mund të favorizojë një operator të caktuar ekonomik. Duke qenë se AK nuk ka përcaktuar qartë këtë kërkesë, vendimi i saj nuk përmbush në mënyrë të plotë kërkesën për qartësi dhe objektivitet, ashtu siç kërkohet nga LPP.
Megjithatë në fazën në të cilën ndodhet procedura, pretendimi ankimor i ankuesit në këtë pikë konsiderohet i pabazuar.

Pretendimi Ankimor 3
Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se oferta e tij është eliminuar padrejtësisht për shkak të ndryshimit të njësisë matëse nga litër në kilogram. Ankuesi shpjegon se çmimi i ofertuar ishte për një litër, ndërsa mostrat e dorëzuara ishin në kilogramë, pasi prodhuesi deri tani ka përdorur këtë njësi matëse. Ai thekson se, në rast të rekomandimit për kontratë, furnizimi do të bëhej me paketim prej një litri për secilin artikull, në përputhje me kërkesat e tenderit. Ankuesi gjithashtu nënvizon se ka dorëzuar një deklaratë ku konfirmon se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Duke iu referuar Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, ankuesi argumenton se Autoriteti Kontraktues (AK) duhej të kërkonte informata sqaruese lidhur me këtë çështje, në vend që të përjashtonte ofertën e tij.
Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3
Eksperti shqyrtues ka analizuar në platformën e-prokurimit dosjen e tenderit, përfshirë Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme si dhe Përshkrimin e Çmimeve, dhe ka vërejtur se AK ka kërkuar njësinë matëse "litër" për të gjitha produktet e tenderit.
Në Aneksin 1 të DT-së dhe në Përshkrimin e Çmimit, specifikohet qartë se:

- Antifriz G-12 dhe G-13 duhet të kenë njësinë matëse "litër" dhe të paketohen në 1 litër.

Eksperti shqyrtues më tej sqaron se, nga dokumentacioni i tenderit, është e qartë se njësia matëse e kërkuar ka qenë "litër", dhe çdo devijim nga kjo kërkesë mund të përbëjë një arsye të ligjshme për eliminim.
Sipas Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 19.11, *"Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm. Çdo shmangie nga këto kërkesa mund të çojë në diskualifikimin e ofertës si e papërgjegjshme".*
AK ka vepruar në përputhje me specifikimet teknike të tenderit, duke kërkuar që ofertat të paraqiten sipas njësisë matëse të përcaktuar dhe të mos devijojnë nga kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit.
Prandaj, edhe në këtë pikë, pretendimi ankimor i ankuesit konsiderohet i pabazuar.

PËRFUNDIMI
Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit dhe pretendimeve të ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të konsiderohet pjesërisht e bazuar.
Ankuesi pretendon shkelje të paragrafit 1 dhe paragrafit 6 të Nenit 7 të LPP, duke argumentuar mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë. Nga shqyrtimi i DT-së, nuk konstatohet shkelje e Nenit 7, paragrafi 1, pasi AK ka vepruar në përputhje me Rregulloren Nr. 002/2024, neni 19.11, duke eliminuar ofertën e ankuesit për devijim nga specifikimet teknike. Nuk ka dëshmi për diskriminim.
Megjithatë, sa i përket përputhshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë, AK nuk ka përcaktuar qartë nëse temperatura minimale e ngrirjes (-37°C) duhet të arrihet pa përzierje, duke krijuar hapësirë për interpretim dhe duke ngritur nevojën për qartësi më të madhe në specifikimet teknike, në përputhje me Nenin 7, paragrafin 6.
Në përputhje me të dhënat e mësipërme, ankesa duhet të konsiderohet pjesërisht e bazuar

vetëm në këtë aspekt, ndërsa pretendimet e tjera nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe konsiderohen të pabazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Gentian Sakaj B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Valmirë Deliu